

# STATUT

## I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR “The Plaza Tirana”SH.P.K.

### KAPITULLI - I

#### DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

##### Neni 1

##### Emërtimi

1.1 Emërtimi i shoqërisë është “THE PLAZA TIRANA” SH.P.K. Ky emërtim është i vetmi i shoqërisë dhe përdoret në të gjithë rregjistrimet, transaksionet, marrveshjet dhe komunikimet e saj me të tretët apo shtetin dhe është i vlefshëm si jashtë dhe brenda vendit.

1.2 Shoqëria “THE PLAZA TIRANA” SH.P.K., është shoqëri me përgjegjesi te kufizuar.

1.3 Shoqëria ka vulën e saj identifikuese.

1.4 Vula e shoqërisë mund të ndryshojë vetëm me vendimin e asamblese se përgjithshme.

##### Neni 2

##### Ortakët

2.1 Është ortakë i shoqërisë në kushtet dhe me të dhënat e mëposhtme:

- Shoqëria “Agna”sh.a e sh.a me seli Gjirokaster, e regjistruar me vendim të Gjykatës së Tiranës Nr.8827 dt. 14.12.1993 dhe NIPT J62903631L – zoteruese e 55 % të kapitalit të shoqërisë”The Plaza Tirana”sh.p.k., perfaqësuar nga:
- **Z.Kristo NAÇI**, i biri i Spiros, shtetas Shqiptar, i lindur me 28 Prill 1973, ne Gjirokaster, mbajtes i leternjoftimit me nr: 034617347, banues ne Tirane, madhor me zotesi te plote juridike per te vepruar, zoterues i 30% te aksioneve dhe Administrator i shoqërisë.
- **Z.Vasil NAÇI**, i biri i Spiros, shtetas Shqiptar, lindur me 01 Shtator 1969, ne Gjirokaster, banues ne Tirane, mbajtes i leternjoftimit me nr: 035236172, madhor dhe me zotesi te plote juridike dhe per te vepruar zoterues i 32.5% te aksioneve te shoqërisë.
- **Z.Kosta SOTIRI**, i biri i Nikos, shtetas Shqiptar, i lindur me 15 Nentor 1962 ne Gjirokaster, banues ne Gjirokaster, mbajtes i leternjoftimit me nr: 035247409, madhor me zotesi te plote juridike per te vepruar, zoterues i 32.5% te aksioneve te shoqërisë.

- **Z.Aleksander NAÇI**, i biri i Spiros, shtetas shqiptar, i lindur ne 01 Qershor 1984, ne Gjirokaster dhe banues ne Tirane, mbejtes i leternjoftimit me Nr: 033290928, zoterues i 5% te aksioneve te shoqerise, madhor dhe me zotesi te plote juridike dhe per te vepruar.
- **Shoqeria “TID” SH.P.K** me seli ne Tirane , e regjistruar me vendim te Gjykares Tirane Nr.20374 dt. 03.12.1998 me **NIPT J82427007R** e perfaqesuar nga:
- Administratori dhe njekoheesisht ortaku i vetem i shoqerise Z. Behar Male. I biri I Skenderit , I datlindjes 20.03.1964 , lindur ne Permet dhe banues ne Tirane I indentifikuar me leter njoftimin Nr. 034287191 madhor e me zotesi te plote per te vepruar - zoterues i 45 % te kapitalit te shoqerise”The Plaza Tirana”sh.p.k.,

### Neni 3 Objekti i shoqërisë

3.1 Objekti i shoqërisë në përputhje me legjislacionin aktual tregtar shqiptar do të jetë:

3.2. Aktivitet ne fushen e turizmit, hapja dhe manaxhimi i hoteleve, e godinave dhe ambjenteve ne te cilat ushtrohet aktivitet hotelier.Hapja dhe manaxhimi i sallave te konferencave ne kuader te aktivitetit hotelier. Hapja, manaxhimi dhe funksionimi i qendrave te rekreacionit, me ose pa profil te dermo-estetikes, trajtimit te lekures dhe trupit, per masazhe, spa, mirembajtje trupore, fitness,dhe pishina. Aktivitet ne fushen e qiradhenies se zyrave, ambjenteve tregtare dhe/ose pasurive te tjera te paluajtshme qe i perkasin hotelit. Kryerja e tregtimit, prodhimit dhe perpunimit te mallrave, qe kane te bejne me aktivitetin e hotelerise. Hapja e manaxhimi i bareve dhe restoranteve brenda struktures hoteliere si edhe ushtrimi i aktivitetit ne fushen e kembimit valutor dhe te mallrave te çmuar, bizhuteri, apo sende me vlere te kuotuara ne burse. Hapja dhe mbajtja e aktiviteve te lojrave te fatit e kazinove, brenda strukturave hoteliere dhe çdo gje tjeter qe perfshijne fushat e mesiperme, te lejuara nga ligji.

### Neni 4 Selia e shoqërisë dhe Zyrat e përfaqesimit

4.1 Selia e shoqërisë është në Tiranë, ne adresen:

Rruga “Abdi Toptani”, Kati i katert, Godises 85m e larte, ne kullen 1J, ne Zonen Kadastrale 8150, njesia me numer 22, pasuria me numer 1/528-N22, , Njesia Bashkiake Nr: 2. Tirane.

4.2 Veprimtaria e shoqërisë ne tërë territorin e Republikës së Shqipërisë kryhet nga degët e saj, të cilat funksionojnë në rrethe apo ndarje të tjera administrative te Republikës së Shqiperisë nën drejtimin e Drejtorisë.



4.3 Shoqëria mund të çele degë dhe zyra përfaqesimi të reja jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë. Ato hapen dhe prishen me vendim të të Asamblesë së Përgjithshme të saj.

4.4 Asambleja e Përgjithshme mbikëqyrë zbatimin e politikave tregtare të administratoreve të shoqërisë, organizon punën, përcakton mënyrën e funksionimit dhe emëron organet drejtuese dhe përfaqësuesit e tyre ligjor.

## **Neni 5** **Kohëzgjatja e shoqërisë**

5.1 Kohëzgjatja e shoqërisë "THE PLAZA TIRANA" SH.P.K.. është pa afat dhe ka filluar në momentin e regjistrimit të shoqërisë në Qendren Kombëtare të Regjistrimit Tirane.

5.2 Ky afat mund të ndryshohet në çdo kohë me vendim të Asmblesë së Përgjithshme të Ortakëve me të njëjtin kuorum që përcakton ligji tregtar për ndryshimin e statutit.

5.3. Shoqëria mund të priset gjyqësisht përpara këtij afati në rastet kur humbet kuptimi moral dhe ligjor i egzistencës së saj apo kur parashikohet shprehimisht në ligj, nëpërmjet kërkesës së çdo aksioneri drejtuar gjykatës.

## **KAPITULLI - II**

### **KAPITALI , KUOTAT DHE KALIMI I KUOTAVE**

#### **Neni 6** **Kapitali**

6.1. Kapitali i shoqërisë është në vlerë 948.000.000(nenteqintedyzetëtetemiljon) lekë dhe përbëhet nga dy kuota me vlerë nominale secila në proporcion me përqindjen e zoterimit të kapitalit nga ortakët e shoqërisë, të numërtuar në mënyrë progresive nga numri 1 deri tek numri 2. Të gjitha kuotat e shoqërisë, pavarësisht nga numërtimi, janë të barazvlefshme me % e zoterimit të kapitalit nga ortakët.

6.2. Numërtimi i kuotave ka vlerë indikative dhe nuk shërben për të treguar përparësinë në shlyerje, tjetërsim apo në likuidim.

6.3. Pronësia mbi kapitalin të shoqërisë është si më poshtë:

- **shoqëria "Agna"sh.a**, zoteron 55% të kapitalit, në vlerë prej 521.400.000 leke i përbere nga një pjesë,
- **shoqëria "TID"sh.p.k**, zoteron 45% të kapitalit, në vlerë prej 426.600.00 leke i përbere nga një pjesë.

#### **Neni 7** **Depozitimi i kapitalit**

Kapitali i shoqërisë është shlyer plotësisht nga ortakët në përpjestim me pjesët takuese në kapital.

## **Neni 8 Ndryshimi i kapitalit**

8.1. Kapitali i shoqërisë mund të zmadhohet apo të zvoglohet vetëm Vendim te Asamblesë së Përgjithshme. Në çdo rast, ndryshimi i kapitalit të shoqërisë duhet të jetë i arsyetuar dhe i shoqëruar me relacionin e Ekspertit Kontabël të shoqërisë.

8.2. Ortaku ka te drejten e perparemise per nënshkrimin e kuotave te shlyeshme ne para qe emetohen per zmadhimin e kapitalit. Kjo e drejte eshte ne perpjestim me shumen e kuotave te zotëruara nga ortaku përpara zmadhimit te kapitalit.

8.3. Ortaku mund te heqe dore vetem individualisht nga e drejta per nënshkrimin e kuotave te reja. Ai, gjithashtu, ka te drejte te kerkoje nënshkrimin e nje numri me te vogel kuotash nga sa i takon sipas parimit te perpjestueshmerise, por me kusht qe Asambleja te kete vendosur shprehimisht per kete gje.

8.4. Procedurat për ndryshimin e kapitalit të shoqërisë duhet të fillojnë brenda tre muajsh nga dita e marrjes së vendimit sipas rastit, te Ortakut te vetem si dhe te Asamblese se Përgjithshme, përndryshe janë të pavlefshme.

8.5. Brenda 3 vjetësh nga dita e kryerjes së ndryshimeve duhet të regjistrohet vendimi pranë Qendrës Kombëtare të Rregjistrimit.

## **Neni 9 Mënyrat e shtimit të kapitalit**

9.1. Shtimi i kapitalit të shoqërisë bëhet në një nga mënyrat e mëposhtme:

a) me emetimin e kuotave të reja, duke shtuar numrin e kuotave që përbëjnë kapitalin të shoqërisë pa ndryshuar vlerën nominale të kuotes.

b) me rritjen e vleres nominale të çdo kuote pa ndryshuar numrin e përgjithshëm të tyre.

9.2. Kompetente për caktimin e mënyrës së shtimit të kapitalit është, Vendimi i ortakut te vete, ose Asambleja e Përgjithshme, pasi merr në shqyrtim relacionin e Ekspertit Kontabël të Regjistruar.

9.3. Kuotat e reja shlyhen me para në dorë, me kompesim të një kredie të kërkueshme të shprehur në para, me përfshirje të rezervave, fitimeve apo primeve, apo me kontribut në natyrë.

9.4. Ortaku i cili shlyen kuotat e reja në një formë tjetër nga shlyerja me para në dorë, duhet ta japi miratimin e tij me shkrim.

9.5. Zmadhimi i kapitalit nëpërmjet rritjes së vlerës nominale të kuotave bëhet vetëm me pëlqimin unanimit të ortakëve.

## **Neni 10 Mënyrat e fitimit dhe kalimit te kuotave**

10.1. Kuotat e kapitali te shoqerise dhe te drejtat qe rrjedhin prej tyre mund te fitohen apo kalohen nepermjet:

a)kontributit ne kapitalin e shoqerise,

b)shitblerjes,

c)trashegimise,



d)dhurimit,

e)çdo menyre tjeter te parashikuar ne ligj.

10.2. Ne rastin e kalimit te kuotave me kontrate, kontrata duhet te behet me shkrim.

10.3. Pjeset e Kapitalit, jane lirisht te transferueshme midis Ortakeve.

10.4.Kalimi i kuotave, te personat e trete, behet me miratimin e asamblese se pergjithshme te ortakeve, me te drejten e parablerjes ne favor te ortakeve te tjere.

a. Ortaku Transferues, duhet t'i njoftoje Ortakeve te tjere, numrin/perqindjen e Pjeseve te Kapitalit qe do te transferohen, çmimin e shitjes ne rast shitjeje, bleresin potencial si dhe te dhena te tjera qe vleresohen thelbesore ne lidhje me transferimin.

b. Transferimi duhet te miratohet nga Asambleja e Pergjithshme e Ortakeve brenda 1 (nje) muaji nga dita e njoftimit. Ne rast se Asambleja nuk ka bere te ditur vendimin e saj brenda afatit nje mujor, miratimi quhet i dhene.

c. Ne rast se Asambleja refuzon transferimin, brenda 1 (nje) muaji nga data e refuzimit, ortaket duhet t'i blejne Pjeset e Kapitalit te propozuara per transferim, proporcionalisht me Pjeset e zoteruara te Kapitalit, pervec rastit kur bien dakort ndryshe. Cmimi i shitjes eshte çmimi i propozuar nga Ortaku Transferues ne piken a. ose nje cmim i ndryshem i rene dakort mes paleve.

d. Ne rast te kalimit te afatit nje mujor nga dita e refuzimit dhe Asambleja e Ortakeve nuk ka shprehur asnje vullnet, atehere Ortaku transferues ka te drejte te shesi pjesen takuese te kotes, atje ku e gjykon te arsyeshme ai.

## **Neni 11**

### **Pasojat e kalimit te kuotave**

11.1.Personi qe kalon kuoten dhe ai qe e fiton ate pergjigjen ne menyre solidare ndaj shoqerise per detyrimet qe rrjedhin nga zotërimi i kuotes, nga casti i kalimit te kuotave, deri ne castin e regjistrimit te kalimit sipas kërkesave te te përcaktuara ne piken 11.2. te këtij neni.

11.2.Shoqeria regjistron kalimin e kuotes sipas kërkesave te ligjit te Qendres Kombetare te Regjistrimit.

## **Neni 12**

### **Te drejtat e lidhura me kuotat**

12.1 Ortaku, qe pengohet te ushtroje te drejtat qe rrjedhin nga zotërimi i kuotes se shoqerise, ka te drejte t'i kerkoje gjykates te urdheroje ndalimin e cenimit apo shpërblimin e demit te shkaktuar.

Kjo e drejte parashkruhet brenda 3 vjeteve nga casti i cenimit.

## **KAPITULLI III – ORGANET E SHOQËRISË ASAMBLEJA E PERGJITHSHME**

## **Neni 13**

### **Te drejtat dhe detyrimet**

13.1. Asambleja e Pergjithshme është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për shoqërinë për çështjet e mëposhtme:

- a) përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
- b) ndryshimin e statutit;
- c) emërimin e shkarkimin e administratoreve;
- d) emërimin e shkarkimin e likuiduesve dhe të eksperteve kontabël të regjistruar;
- dh) përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjat “c” dhe “d” të kësaj pike;
- e) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- f) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë të veprimtarisë;
- g) zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
- gj) pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
- h) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratoreve;
- i) riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
- j) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblese;
- k) çështje të parashikuara nga ligji dhe ky statut.

13.2. Asambleja e Pergjithshme merr vendime për çështjet e përcaktuara në shkronjen “f” dhe “g” të pikës 1 të këtij neni, pas marrjes dhe shqyrtimit të dokumentave përkatëse.

13.3. Kur shoqëria është me një ortak, të drejtat dhe detyrimet e asamblese së përgjithshme ushtrohen nga ortaku i vetëm. Të gjitha vendimet e marra nga ortaku i vetëm regjistrohen në regjistrin e vendimeve. Do të regjistrohen në veçanti, por pa u kufizuar në to, vendimet për:

- a) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- b) shpërndarjen e fitimeve vjetore dhe mbulimin e humbjeve;
- c) investime;
- d) vendimet për riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.

#### Neni 14

#### Mbledhja e asamblese së përgjithshme

14.1. Asambleja e Pergjithshme mbledhet në rastet e përcaktuara nga ky ligj, nga ligje të tjera ose nga depozitat e përcaktuara në këtë statut dhe sa here që mbledhja është e nevojshme për të mbrojtur interesat e shoqërisë. Mbledhja e zakonshme e asamblese së përgjithshme thirret të paktën një herë në vit.

14.2. Asambleja e Pergjithshme thirret nga administratorët apo ortakët e përcaktuar sipas nenit 16 të këtij statuti.



14.3. Asambleja e Pergjithshme thirret kur shoqëria propozon te shese apo te disponoje ne menyre tjeter aktive, te cilat kane nje vlere me te larte se 5 perqind te aseteteve te shoqerise, qe rezulton ne pasqyrat e fundit financiare te certifikuara.

14.4. Mbledhjet e Asamblese se Pergjithshme mund te kryhen edhe nepermjet video konferencave, apo nepermjet te gjitha formave elektronike te komunikimit ku ky komunikim behet ne kohe reale nepermjet zerit ose/dhe figures, mjafton qe pjesemarresit ne mbledhjet ku marrin pjese te gjithe Ortaket, ose personat e Autorizuar te tyre te kene mundesine e identifikimit.

### **Neni 15** **Menyra e Thirrjes**

15.1. Asambleja e Pergjithshme thirret nepermjet nje njoftimi me shkrese ose, nese parashikohet nga ky statut, me njoftim nepermjet postes elektronike. Njoftimi me shkrese apo me mesazh elektronik duhet te permbaje vendin, daten, oren e mbledhjes dhe rendin e dites e t'u dergohet te gjithe ortakeve, jo me vone se 21 dite perpara dates se parashikuar per mbledhjen e asamblese.

15.2. Kur asambleja e pergjithshme nuk thirret sipas pikes 1 te ketij neni, ajo mund te marre vendime te vlefshme vetem nese te gjithe ortaket jane dakort, per te marre vendime, pavarësisht parregullsise.

### **Neni 16** **Kerkesa nga ortaket e pakices**

16.1. Ortaket qe perfaqesojne te pakten 5 per qind te totalit te votave ne asamblene e pergjithshme te shoqerise, mund t'i drejtojne administratoreve nje kerkesa me shkrim, perfshi posten elektronike, per te thirrur asamblene e pergjithshme dhe/ose perfshirjen e ceshtjeve te posaçme ne rendin e dites. Kerkesa duhet te permbaje arsyet, objektivat dhe ceshtjet, per te cilat asambleja duhet te marre nje vendim. Nese kerkesa refuzohet, keta ortake kane te drejte te thërrasin asamblene dhe te caktojne ceshtjet e rendit te dites, duke bere njoftimin me shkrese ku duhet te permbaje vendin, oren e mbledhjes dhe rendin e dites e t'u dergohet te gjithe ortakeve, jo me vone se 7 dite perpara dates se parshikuar per mbledhjen e asamblese.

16.2. Nese, ne kundërshtim me piken 16.1 te ketij neni, asambleja e pergjithshme nuk thirret, ose ceshtja e kerkuar prej ketyre nuk futet ne rendin e dites, secili prej ortakeve, qe kane bere kerkesen, kane te drejte:

a) te ngrejne padi ne gjykate, per te deklaruar shkeljen e detyrimit te besnikerise, nese administratoret nuk permbushin kerkesat e ortakeve brenda 15 diteve;

b) t'i kerkoje shoqerise blerjen e kuotave, te zotëruara prej tyre.

16.3. Ne rastet kur rendi i dites ndryshohet, sipas parashikimeve te pikave 16.1. e 16.2 te ketij neni dhe thirrja i eshte njoftuar ortakeve, administratoret njoftojne perseri rendin e dites, te ndryshuar duke bere njoftimin me shkrese ku duhet te permbaje vendin, oren e mbledhjes dhe rendin e dites e t'u dergohet te gjithe ortakeve, jo me vone se 7 dite perpara dates se parshikuar per mbledhjen e asamblese.

16.4.Perfaqesuesi i autorizuar eshte i detyruar te deklarroje cdo fakt apo rrethane, te tille qe sipas gjykimit te ortakut te perfaqesuar, rrezikon te ndikojne ne vendimmarrjen e perfaqesuesit per interesa te tjere te ndryshem nga ata te ortakut te perfaqesuar.

### **Neni 17**

#### **Perfaqesimi ne asamble**

17.1.Ortaku mund te perfaqesohet ne asamblene e pergjithshme, ne baze te nje autorizimi nga nje ortak tjetër apo nga nje person i trete.

17.2.Administratoret e shoqerise nuk mund te veprojne si perfaqesues te ortakeve ne asamblene e pergjithshme.

17.3.Autorizimi mund te jepet vetem per nje mbledhje te asamblese se pergjithshme, e cila perfshin edhe mbledhjet vijuese me te njejtin rend dite.

### **Neni 18**

#### **Kuorumi**

18.1 Ne rast vendimesh te zakonshme, Asambleja e Pergjithshme mund te marre vendime te vlefshme vetem nese jane te pranishem Ortaket zoterues te me shume se 50% (pesedhjete perqind) te Pjeseve te Kapitalit me te drejte vote. Nese Asambleja e Pergjithshme nuk mund te mblidhet per shkak te mungeses se Kuorumit ne thirrjen e pare, Asambleja mund te mblidhet perseri me te njejtin rend dite brenda dhe jo me vone se 30 dite nga thirrja e pare. Ne rast vendimesh te zakonshme, keto te fundit merren me voten pro te 51% (pesedhjete e nje perqind) te Ortakeve te pranishem apo te perfaqesuar.

18.2 Ne rast vendimesh te jashtezakonshme, Asambleja e Pergjithshme mund te marre vendime te vlefshme vetem nese jane te pranishem Ortaket zoterues te me shume se 75% te Pjeseve te Kapitalit me te drejte vote. Nese Asambleja e Pergjithshme nuk mund te mblidhet per shkak te mungeses se Kuorumit ne thirrjen e pare, Asambleja mund te mblidhet perseri me te njejtin rend dite brenda 30 dite nga thirrja e pare. Ne rast vendimesh te jashtezakonshme, keto te fundit merren me voten pro te 75% (shtatedhjete e pese perqind) te Ortakeve te pranishem.

18.3.Nese asambleja e pergjithshme nuk mund te mblidhet per shkak te mungeses se kuorumit te permendur ne piken 18. 1 dhe 18.2 te ketij neni, asambleja mblidhet perseri jo me vone se 30 dite, me te njejtin rend dite.

### **Neni 19**

#### **Marrja e Vendimeve**

19.1. Asambleja e pergjithshme vendos me tri te katertat e votave te ortakeve pjesemarres, sic percaktohet ne piken 1 te nenit 15, per ndryshimin e statutit, zmadhimin ose zvogelimin e kapitalit te regjistruar, shperndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqerise.Ortakët kanë të drejtë të ushtrojnë të gjitha të drejtat që kanë në shoqëri sipas ligjit dhe Statutit personalisht apo nëpërmjet përfaqesuesve të tyre.



19.2. Kur përfaqësimi është i përcaktuar në statut ai është i vlefshëm në vazhdimësi dhe mund të ndryshohet në të njëjtat kushte të kërkuara për ndryshimin e Statutit. Ndryshimi i përfaqësimit statutor duhet të depozitohet në Rregjistrin Tregtar për efekt vlefshmërie.

19.3 Ortaket pranojnë dhe bien dakord që vendimet të merren edhe nepermjet Vendimeve Qarkulluese me Shkrim, pa qene nevoja per tu thirrur ne Asamblene e Pergjithshme. Draft-Vendimet e propozuara do t'u dergohen Ortakeve me poste te rregjistruar, fax, e-mail ose menyra te tjera elektronike te sigurta. Ortaket do te votojne ne lidhje me Draft-Vendimet, brenda nje periudhe prej 15 ditesh nga dita qe ju eshte dorezuar ky Draft dhe do te miratojne Vendimet Qarkulluese duke ia kthyer, me poste te rregjistruar, Administratorit te Shoqerise, nje kopje te firmosur. Vendimi Qarkullues me shkrim do te konsiderohet i miratuar nese aprovohet nga shumica e kerkuar nga Ligji per Shoqerite Tregtare dhe ky Statut dhe Administratori shpall rezultat e tij.

### **Neni 20** **E drejta e votës**

20.1. Çdo kuote i jep zotëruesit të tij të drejtën e votës në përpjestim me përqindjen e zoterimit të kapitalit. Ortakët shprehin me votën e tyre vetëm një qëndrim për të gjithë kuotat që zotërojnë. Totali i kuotave që zotëron një ortak nuk mund të ndahet për efekt votimi në pjesë.

20.2. Ortaket që nuk janë të pranishëm, ju parashikohet mundësia e pjesëmarrjes në mbledhje të asamblese së përgjithshme me mjete të ndryshme komunikimi, përfshirë mjetet elektronike, me kusht që të garantohet identifikimi i ortakeve.

20.3. Ortaket kanë të drejtë të marrin unanimisht çdo vendim, me kusht që kjo marrëveshje të bëhet me shkrim.

### **Neni 21** **Perjashtimi nga e drejta e votës**

21.1. Ortaku nuk mund të ushtroje të drejtën e votës nëse asambleja e përgjithshme merr vendim për:

- a) vlerësimin e veprimtarisë së tij;
- b) shuarjen e ndonjë detyrimi në ngarkim të tij;
- c) ngritjen e një padie ndaj tij nga shoqëria;
- d) dhënien ose jo të përfitimeve të reja.

21.2. Kur ortaku përfaqësohet nga një përfaqësues i autorizuar, i autorizuari vlerësohet të jete në të njëjtin konflikt interesi, ashtu si dhe ortaku, të cilin përfaqëson.

### **Neni 22** **Procesverbalet e mbledhjes së asamblesë**

22.1. Të gjitha vendimet e asamblese së përgjithshme duhet të regjistrohen në procesverbal. Administratorët përgjigjen për ruajtjen e kopjave të procesverbaleve të asamblese së përgjithshme.

22.2. Procesverbali duhet të përmbajë datën e vendin e mbledhjes, rendin e ditës, emrin e kryetarit e të mbajtësit të procesverbalit, rezultatet e votimit.

22.3. Procesverbalit i bashkelidhet edhe lista e pjesemarrësve, si edhe akti i thirrjes së asamblese së përgjithshme.

22.4. Procesverbali i mbledhjes nënshkruhet nga kryetari dhe nga mbajtësi i procesverbalit.

22.5. Nëse shoqëria ka publikuar një faqe në internet, administratoret, jo më vonë se 15 ditë nga data e mbledhjes, janë të detyruar të publikojnë kopjo të procesverbalit të mbledhjes së asamblese së përgjithshme në këto faqe.

### **Neni 23** **Hetime të posaçme**

23.1. Asambleja e përgjithshme mund të vendosë nisjen e një hetimi të posaçëm për parregullsitë e veprimeve të ushtrimit të veprimtarisë tregtare. Hetimi kryhet nga një ekspert i pavarur i fushës.

23.2. Ortaket që përfaqësojnë të paktën 5 përqind të totalit të votave të asamblese së shoqërisë, mund të kërkojnë asamblese së përgjithshme emërimin e një eksperti të pavarur të fushës, kur ka dyshime të bazuara për shkelje të ligjit ose të statutit. Ortaket ose kreditorët e shoqërisë të përcaktuar më sipër, brenda 30 ditëve pas refuzimit nga asambleja për emërimin e ekspertit të pavarur, mund të kërkojnë gjykatës emërimin e këtij eksperti. Nëse asambleja e përgjithshme nuk merr vendim brenda 60 ditëve nga data e paraqitjes së kërkesës, kërkesa e ortakeve vlerësohet e refuzuar.

23.3. Kur asambleja e përgjithshme ka emruar një ekspert të fushës për kryerjen e hetimit të posaçëm dhe kur për këto emrim ka dyshime të bazuara për të besuar se eksperti mund të mos realizojë hetimin e posaçëm në mënyrën e duhur, ortaket ose kreditorët e përmendur në pikën 23.2 të këtij neni mund të kërkojnë gjykatës zëvendësimin e tij.

23.4. Kur gjykata pranon kërkesat e përmendura në pikat 23.2 e 23.3 të këtij neni, shoqëria tregtare përballon kostot e emerimit dhe të shpërblimit të ekspertit të emruar për kryerjen e hetimit të posaçëm.

23.5. E drejta për të kërkuar hetim të posaçëm, sipas pikave 23.1 e 23.2 të këtij neni, duhet të ushtrohet brenda 3 vjetëve nga data e veprimit, që konsiderohet i parregullt, kur hetimi ka si objekt parregullsitë e ushtrimit të veprimtarisë tregtare.

23.6. Kreditori, që në keqbesim paraqet një kërkesë, sipas pikës 23.2 të këtij neni, përgjigjet në përputhje me nenin 34 të Kodit të Procedurës Civile.

### **Neni 24** **Shfuqizimi i vendimeve të parregullta dhe dëmshpërblimi**

24.1. Asambleja e përgjithshme ka të drejtë të kërkojë gjykatës perkatëse shfuqizimin e vendimeve të administratoreve, kur këto përbejnë shkelje të rëndë të ligjit ose të statutit.

24.2. Ortaket, të cilët përfaqësojnë të paktën 5 përqind të totalit të votave në asamblese së shoqërisë, apo secili prej kreditorëve të shoqërisë mund të kërkojnë asamblese së përgjithshme ngritjen e padi si më sipër. Ortaket e shoqërisë së përcaktuar më sipër, brenda 30 ditëve pas refuzimit nga asambleja për ngritjen e padi, kanë të drejtë të ngrenë padi drejtperdrejtë përpara gjykatës kompetente për shfuqizimin e vendimit të administratoreve. Nëse asambleja nuk merr vendim brenda 60 ditëve nga data e kërkesës, kërkesa e ortakeve apo kreditorëve vlerësohet e refuzuar.



24.3. Ne rastet kur shoqëria ngre padi si me sipër, ajo merr pjesë në gjykim me anë të një perfaqësuesi të posaçëm, të caktuar nga asambleja e përgjithshme.

24.4. Ortaket e përmendur në pikën 24.2 të këtij neni mund të kërkojnë gjykatës zëvendësimit të perfaqësuesit të posaçëm, kur ka dyshime të bazuara në perfaqësuesin e emeruar nga asambleja e përgjithshme mund të mos ngreje e ndjeke padinë në interesin me të mirë të shoqërisë. Nëse gjykata e pranon këto kërkesë, kostot e emerimit dhe të shpërblimit të perfaqësuesit përballohen nga shoqëria.

24.5. Gjykata vendos shpalljen e pavlefshmerisë së vendimeve të administratoreve, nëse këta nuk merren vesh, me pajtim, me perfaqësuesin e posaçëm për korrigjimin e pasojave të vendimit, brenda 30 ditëve nga data e emerimit të këtij perfaqësuesi. Të drejtat e paleve të treta mbeten të pacenuara, në përputhje me pikën 3 të nenit 12 të Ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për tregtare e shoqëritë tregtare".

## ADMINISTRATORET

### Neni 25

#### **Emerimi, shkarkimi, të drejtat dhe detyrimet**

25.1. Asambleja e përgjithshme emeron një ose me shumë persona fizike si administratore të shoqërisë. Afati i emërimit, i cili caktohet në statut, nuk mund të jetë më i gjatë se 5 vjet, me të drejtë ripërteritjeje. Emerimi i administratoreve prodhon efekte pas regjistrimit në Qendren Kombëtare të Regjistrimit.

25.2. Administratoret e një shoqërie tregtare mëmë, sipas përcaktimit të nenit 207 të Ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për tregtare e shoqëritë tregtare", nuk mund të emerohen si administratore të një shoqërie të kontrolluar e anasjelltas.

25.3. Administratoret kanë të drejtë e detyrohen të:

- a) kryejnë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikën tregtare, të vendosura në asambletë e përgjithshme;
- b) perfaqësojnë shoqërinë tregtare;
- c) kujdesen për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumentave dhe të librave kontabël të shoqërisë;
- d) përgatisin dhe nënshkruajnë bilancin vejtör, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente përpara asambletë së përgjithshme për miratim;
- e) krijojnë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat, që kërcenojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
- f) kryejnë regjistrimet dhe dergojnë të dhenat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendren Kombëtare të Regjistrimit;
- g) raportojnë përpara asambletë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçante për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;
- gj) të lidh kontrata, e të kryej veprime të ndryshme bankare brenda limitit që i lejon Ortaku i vetëm ose Asambleja e përgjithshme;
- h) kryejnë detyra të tjera të përcaktuara në ligj dhe në këto statute;
- i) të lidh kontratat e punës me të punësuarit në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi.

25.4. Ne rastet e parashikuara nga pikat 14.3 e nenit 14 te këtij statuti, administratoret jane te detyruar te thërrasin asamblene e përgjithshme.

25.5. Nese asambleja e përgjithshme emerone me shume se nje administrator, ata e administrojne bashkërisht shoqerine.

25.6. Asambleja e përgjithshme mund te shkarkoje administratorin ne cdo kohe me shumice te zakonshme.

## **Neni 26** **Përfaqësimi**

26.1. Kufizimet e tagrave te perfaqesimit te administratoreve i kundrejtohen paleve te treta, ne përputhje me dispozitat e nenit 12 te Ligjit nr. 9901, date 14.04.2008“Per tregtare e shoqerite tregtare”.

26.2. Administratoret, qe përfaqësojne bashkarisht shoqërinë tregtare, mund te autorizojne disa prej tyre per kryerjen e disa veprimeve te caktuara apo per kryerjen e disa kategorive te caktuara veprimesh. Njoftimet e drejtuara secilit prej administratoreve jane te vlefshme e detyruese per shoqerine.

26.3. Tagrat e perfaqesimit te administratoreve dhe cdo ndryshim i tyre njoftohen per regjistrim prane Qendres Kombetare te Regjistrimit.

26.4. Administratori i shoqerise do te jete Znj. Steljana Mile me kohe zgjatje deri ne marrjen e nje vendimi tjetër te asamblese te shoqerise, por pa kaluar afatin maksimal prej 5-vjetesh i përcaktuar ne nenin 95 te Ligjit Nr. 9901, date 14.04.2008“Per tregtare e shoqerite tregtare”, me te drejte ripërteritje.

## **Neni 27** **Përgjegjësia e Administratorit**

27.1. Administratori është i detyruar të ruajë sekretet e Shoqërisë për të cilat vihet në dijeni gjatë ushtrimit të detyrës.

27.2. Kur nga veprimet apo mosveprimet e tij në mospërputhje me ligjin apo me këtë Statut i shkaktohet një dëm material apo moral Shoqërisë, ai përgjigjet civilisht për dëmin e shkakuar në mënyrë të pakufizuar.

## **Neni 28** **Shpërblimi i Administratorit**

28.1. Shpërblimit baze te administratoreve mund ti behen shtesa, qe mund te jene ne përqindje ne fitim ose te ngjashem. Shpërblimet e administratoreve përcaktohen me vendim te zakonshem te asamblese se përgjithshme.

28.2. Shpërblimi, sipas pikes 28.1 te këtij neni, duhet te jete i pershtatshem dhe ne përputhje me detyrat e administratoreve dhe gjendjen financiare te shoqerise.

28.3. nese shoqëria eshte ne veshtiresi financiare, asambleja e përgjithshme mund te vendose reduktimin e shpërblimit te administratoreve ne mase te pershtatshme.

28.4. Kriteret e shpërblimit, shpërblimi individual dhe efekti vjetor i shpërblimit te administratoreve ne strukturen e kostove te shoqerise tregtare publikohen se bashku me pasqyrat financiare vjetore.



**Neni 29**  
**Kontrolli financiar i Asamblesë**

- 29.1. Administratori i paraqet organit vendim-marres, si ortakut te vetem ose Asamblesë së përgjithshme llogaritë vjetore dhe kur është rasti llogaritë e konsoliduara.
- 29.2. Ekspertët kontabël parqesin përpara organit vendim-marres, ortakut te vetem ose Asamblesë së përgjithshme kryerjen e detyrave të tyre të ngarkuara sipas ligjit.
- 29.3. Organi vendim-marres, ortakut i vetem ose Asambleja e përgjithshme shqyrton dhe vendos për të gjitha çështjet financiare të vitit të kaluar.

**Neni 30**  
**Përfaqësimi tek të tretët**

- 30.1. Administratori përfaqëson shoqërinë në marrdhëniet me të tretët.
- 30.2. Ankesat apo kërkesat që i drejtohen shoqërisë nga të tretët janë të vlefshme kur i komunikohen Administratori.
- 30.3. Administratori mund të delegojë një apo disa kompetenca të tij tek anëtarët e administratës së shoqërisë.

**Neni 31**  
**Ndalimi i huadhënies**

Administratoret ndalohen të kontraktojnë në cilëndo formë për të marrë hua nga shoqëria, të japin nëpërmjet saj paradhënie, si dhe të bëhen dorëzanës apo të garantojnë nëpërmjet saj detyrimet e të tretëve.

**KAPITULLI IV - EKSPERTI KONTABËL, VITI FINANCIAR .**

**Neni 32**  
**Ekspertët Kontabël**

- 32.1. Shoqëria duhet të ketë të paktën një Ekspert Kontabël të përhershëm. Eksperti Kontabël caktohet me vendim të Asamblesë së Përgjithshme të shoqërisë dhe duhet të plotësojë kushtet e nevojshme ligjore për të qenë i tillë.
- 32.2. Ekspertët emërohen për një vit financiar. Funkcionet e tyre përfundojnë pas mbledhjes së Asamblesë së përgjithshme, e cila merr vendim mbi pasqyrat financiare vjetore.
- 32.3. Çdo ortak ka të drejtë që në rastet kur shoqëria mbetet pa Ekspert Kontabël apo ligji kërkon emërimin e një eksperti tjetër dhe ky detyrim nuk është plotësuar nga Asambleja, t'i kërkojë gjyaktës caktimin e një Eksperti Kontabël të regjistruar në rrugë gjyqësore.
- 32.4. Eksperti apo Ekspertët Kontabël të shoqërisë thirren në mbledhjen e Drejtorisë e cila mbyll llogaritë e vitit financiar si dhe në të gjitha mbledhjet e Asamblesë së përgjithëshme.

32.5. Eksperti Kontabël i shoqërisë është i detyruar të ruajë sekretet për të cilat vihet në dijeni gjatë ushtrimit të profesionit dhe është përgjegjës për dëmet që i shkakton shoqërisë nga veprimet apo mosveprimet me faj të tij.

### **Neni 33**

#### **Detyrat e ekspertit kontabël**

33.1. Eksperti kontabël i regjistruar garanton rregullshmërinë e pasqyrave financiare vjetore dhe të gjendjes financiare të shoqërisë, verifikon librat e llogarisë dhe fondet e shoqërisë, kontrollojn përshtatjen e kontabilitetit me legjislacionin në fuqi dhe siguron që të jetë respektuar barazia midis ortakeve, si dhe çdo detyrë tjetër që rrjedh shprehimisht nga ligji tregtar shqiptar apo i ngarkohet me vendim të Asamblesë.

33.2. Eksperti ushtron kompetencat e tij dhe mban përgjegjësi që rrjedhin nga kryerja e detyrës në përputhje me dispozitat e këtij statuti dhe ligjit tregtar shqiptar.

### **Neni 34**

#### **Të drejtat e ekspertit**

Eksperti përveç sa i njihet nga ligji për ushtrimin e detyrës ka të drejtë që:

- a) Në mbarim të afatit të funksioneve kur është propozuar shkarkimi i tij, të dëgjohet nga Mbledhja e Asamblesë së përgjithshme.
- b) Të marrë pjesë në mbledhjet e Drejtorisë e cila mbyll logaritë e vitit të kaluar financiar
- c) Si rast përjashtimor, Eksperti Kontabël i përhershëm ka të drejtë që për çështje në të cilat është drejtpërdrejtë përgjegjës t'i kërkojë të thërrasë mbledhjen e Asamblesë. Se përgjithshme është i detyruar që brenda 10 ditëve të fillojë procedurat e thirrjes.

### **Neni 35**

#### **Shpërblimi i Ekspertëve Kontabël**

Shpërblimi i Ekspertëve Kontabël caktohet nga Asambleja me bazë vjetore apo për çdo shërbim, parashikohet si shpenzim i veçantë dhe përballohet nga shoqëria.

### **Neni 36**

#### **Ushtrimi i vitit financiar**

Ushtrimi financiar fillon më 1 janar dhe mbaron më 31 dhjetor të çdo viti. Përjashtimisht ushtrimi i parë financiar përfshin kohën nga data e regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit gjer më 31 dhjetor.

### **Neni 37**

#### **Inventari dhe Pasqyrat Financiare Vjetore**

37.1. Shoqëria do të mbajë një kontabilitet të rregullt të pasurisë dhe të veprimtarisë së saj, në pajtim me kërkesat ligjore.



37.2. Në mbyllje të ushtrimit, drejtori harton inventarin e pasurisë në këtë datë dhe pasqyrat financiare vjetore për ushtrimin financiar në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi për kontabilitetin.

### **Neni 38** **Raportet Vjetore**

38.1. Në mbylljen e çdo viti financiar Drejtimi përveç inventareve dhe llogarive vjetore harton një raport me shkrim për Asamblene e Ortakeve.

38.2. Bilancit i bashkëngjiten një situacion mbi garancitë e dhëna nga shoqëria dhe një situacion mbi sigurimet e bëra nga shoqëria.

38.3. Raporti pasqyron gjendjen e shoqërisë gjatë vitit financiar të kaluar, ndryshimet e parshikuara, veprimtaritë e rëndësishme, etj.

38.4. Një kopje e këtij raporti i jepet Ekspertit Kontabël për miratim.

### **Neni 39** **Rezultatet e ushtrimit dhe caktimi i fitimeve**

39.1. Rezultati i ushtrimit përcaktohet si diferencë ndërmjet të ardhurave dhe shpenzimeve të ushtrimit, duke përfshirë të këto të fundit amortizimet dhe provizionet.

39.2. Shuma e fitimeve të mbetura pas heqjeve për krijimin e rezervave përfaqëson dividendin, i cili mund të shpërndahet, ose do të kalojë për investim në shoqëri në formën e zmadhimit të kapitalit.

39.3. Duke përjashtuar rastin kur është vendosur zvogëlimi i kapitalit, nga fitimet e ushtrimit nuk behët asnjë heqje dhe asnjë derdhje dividendi, në qoftë se kapitalet e veta janë ose do të beheshin më të vogla se shumën e kapitalit themeltar plus shumën minimale të kërkuar për rezervën e domosdoshme.

39.4. Në qoftë se ekziston një humbje, kjo mbartet për t'u përfshirë në fitimet e ushtrimit të ardhshme deri në shuarjen e saj.

### **Neni 40** **Rezerva e domosdoshme dhe e nevojshme**

40.1. Nga fitimi i rezervuar gjatë vitit financiar pasi zbriten humbjet e vitit të mëparshëm, në rast se ka, hiqet mënjandë një shumë e barabartë me 1/20 e fitimit të destinuar për formimin e fondit rezervë të quajtur "rezervë e domosdoshme".

40.2. Heqja nga fitimet për rezervën e domosdoshme pushon së qeni e detyrueshme kur kjo rezervë arrijë 1/10 e kapitalit themeltar. Ajo rifillon kur për një arsye çfarëdo, rezerva e domosdoshme ka zbritur nën 1/10 e kapitalit.

40.3. Nga fitimet e ushtrimit të pakësuar, shoqëria do të heqë jo më shumë se 85% për krijimin e rezervave për zhvillim apo të tjera rezerva të nevojshme .

### **Neni 41** **Fitimi që shpërndahet**

Koha, mënyra dhe shuma e fitimit që shpërndahen vendoset rast pas rasti nga Asambleja e Aksionerëve sipas raportit të Drejtimit dhe Ekspertit Kontabël në përputhje me këtë Statut, ligjin tregtar dhe gjendjen financiare të shoqërisë.

## **KAPITULLI V – PRISHJA E SHOQËRISË RISHJA E SHOQËRISË**

### **Neni 42**

#### **Shkaqet e prishjes së shoqërisë**

Shoqëria me përgjegjesi të kufizuar priset:

- a) kur mbaron kohëzgjatja e parashikuar në themelimin e saj;
- b) me vendimin e asamblese së përgjithshme;
- c) me hapjen e procedurave të falimentit;
- d) nëse nuk ka kryer veprimtari tregtare për dy vjet dhe nuk është njoftuar pezullimi i veprimtarisë në përputhje me pikën 3 të nenit 43 të ligjit nr.9723, datë 03.05.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”;
- f) me vendim të gjykatës;
- g) për arsye të tjera të parashikuara në ligj.

### **Neni 43**

#### **Regjistrimi i shpërbërjes**

Administratoret regjistrojnë prishjen e shoqërisë pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit, në përputhje me nenin 43 të ligjit nr.9723, datë 03.05.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit” ia njofton vendimin Qendrës Kombëtare të Regjistrimeve për regjistrim”.

### **Neni 44**

#### **Dispozita të fundit**

- 44.1. Për të gjitha çështjet që nuk gjejnë rregullim në këtë Statut, aplikohen dispozitat e ligjit nr. 9901 dt. 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”.
- 44.2. Për efekt të interpretimit të këtij Statuti me ligj tregtar nënkuptohet ligji nr. 9901 dt. 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”.
- 44.3. Pavlefshmeritë e dispozitave të veçanta të Statutit nuk çënojnë vlefshmërinë e tij.


### **Neni 45**

#### **Gjykata kompetente**

Gjykata kompetente për zgjidhjen e të gjitha mosmarrveshjeve midis ortakëve dhe interpretimin e statutit të shoqërisë është Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

### **Neni 46**

#### **Hyrja në fuqi**





Ky Statut i rihartuar hyn në fuqi dhe është i detyrueshëm për zbatim në momentin e firmosjes nga ortaket, sot më dt. 26.07.2021.

Vula e shoqërisë mund të ndryshojë vetëm me vendimin e Asamblesë së Ortakeve.

Hartuar në Tiranë më 26.07.2021

**FIRMOSUR NGA  
ORTAKET**

**“AGNA” Sh.a.**

Z.Vasil NACI



Z.Kosta SOTIRI



Z.Kristo NACI



Z.Aleksander NACI



**Per “TID” Shpk**

Z.Behar MALE



TIRANA INTERNATIONAL  
DEVELOPMENT  
TIRANA ALBANIA

